

## **Shtëpia Botuese SHBLSH e RE**

### **Plani mësimor për vitin shkollor 2011 - 2012 në lëndën:**

#### **Biologjia dhe Edukimi shëndetsor 7**

Libri ka tri linja kryesore:

- I. Mbi zbulimin e qelizës (5 orë)**
- II. Sistemet e organeve të njeriut (47orë)**
- III. Shëndeti dhe sëmundjet (10 orë )**

10 orë në dispozicion, ndarja e tyre fakultative në linja.

Në orët e lira mund të organizohen veprimtari në shkollë, për krijimin apo pasurimin e “**Këndit të Shëndetit**”, ku mund të vendosen punimet më të mira të realizuara ose vëzhgime interesante të nxënësve nga internet ose libra jashtëmësimorë, mbi qelizën, mbi sistemet e trupit të njeriut, të reja mbi sukseset e shkencës për riprodhin (in vitro), mbi dëmet e duhanit, të këqijat e AIDS etj.

Në ndonjë veprimtari të përgatitur me kujdes, sidomos mbi shëndetin – problem i rëndësisë së veçantë, mund të ftohen prindër, mësues dhe nxënës të tjerë të shkollës.

#### **Përmbajtja e lëndës “Biologjia dhe Edukimi shëndetsor 7”**

Orë gjithsej	70 orë
Orë njohuri të reja (T)	59 orë
Orë të lira	11 orë

## Shtëpia Botuese SHBLSH E RE

### Plani mësimor: “Biologjia dhe Edukimi shëndetsor 7”

(klasa e shtatë)

Plani mësimor është i bazuar në kurrikulën e miratuar nga MASH.

Kurrikula është zbatuar plotësisht në librin e hartuar, i cili në të gjithë përmbajtjen e tij në çdoorë përputhet me të.

Libri ka objektivat kryesorë dhe specifik.

Linja 1, II, III		<b>Objektiva të përgjithshëm për lëndën</b>
		1.Të identifikojë qelizën si njësinë bazë të jetës. 2.Të përshkruajë strukturën dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes, mbështetjes e lëvizjes; frymëkëmbimit, qarkullimit, ushqimit, jashtëqitjes, riprodhimit, sistemit nervor e hormonal si dhe ndërveprimet e organeve brenda secilit system. 3.Të diskutojë për faktorët që ndihmojnë një shëndet të mirë.
Linja I Mbi zbulimin e qelizës (5 orë)	Titulli i mësimit	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
1	1. Teoria qelizore	Të kuptojë që qeliza është njësia bazë e jetës. Të kuptojë ndërtimin dhe funksionin e qelizës.
2	2. Përbërja e qelizave. Qeliza dhe mikroskopi	Të kuptojë përbërjen e qelizave. Të shpjegojë karakteristikat e mikroskopit elektronik.
3	3. ADN-ja mbartëse e karakteristikave trashëguese të gjallesave	Të shpjegojë rolin e ADN-së si mbartëse e karakteristikave trashëguese të gjallesave. Të kuptojë kalimin nga AND te tiparet e qelizës.
4	4. Organizimi i qelizave në inde, organe aparate dhe sisteme	Të përshkruajë organizimin e qelizave në inde, organe, aparate , sisteme.
5	5. Punë laborator: Vrojtimi në mikroskop i qelizës shtazore	Të dallojë në mikroskop qelizat shtazore. rritjen e shumëllojshmërisë të ushqimeve.

<b>Linja 2.</b> <b>Sistemet e organeve të njeriut (47orë)</b>		
	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
<b>Nënlinja I</b> <b>A.Mbrojtja, mbështetja dhe lëvizja</b>		
1	1. Vështrim i përgjithshëm për trupin e njeriut	Të përshkruajë në përgjithësi ndërtimin e trupit të njeriut
2	2. Lëkura. Ndërtimi i lëkurës, funksionet e lëkurës	Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionet e lëkurës
3	3. Dëmtimi dhe rigjenerimi i lëkurës, higjiena e lëkurës	Të analizojë problemet e dëmtimit dhe rigjenerimit të lëkurës. Të dallojë metoda të pastrimit dhe përkujdesjes ndaj lëkurës
4	4. Struktura e kockave dhe rritja e tyre. Llojet e kockave dhe funksioni i tyre	Të analizojë strukturën, llojet, funksionin dhe rritjen e kockave.
5	5.Një strukturë e qëndrueshme. Rritja e kockave	Të analizojë strukturën e qëndrueshme. Të përshkruajë ndërtimin e një kocke të gjatë.
6	6.Skeleti ynë	Të shpjegojë ndërtimin e skeletit Të dallojë skeleton e kokës, shtyllën kurrizore,kafazin e kraharorit.
7	7.Kockat e gjymtyrëve	Të analizojë ndërtimin dhe funksionimin e kockave të gjymtyrëve.
8	8.Lëvizja aktive	Të njohë dhe kuptojë bashkëpunimin e skeletit dhe muskujve.
9	9.Shëndeti skeletit	Të analizojë mënyrat e parandalimit të çrregullsive dhe plagëve të zakonshme të organeve të lëvizjes.
10	10.Pyetje dhe ushtrime përmbledhëse	Të njohë dhe të përshkruajë trupin e njeriut.
<b>Nënlinja II</b> <b>B. Gjaku dhe qarkullimi i tij</b>	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
1	1. Sistemi i qarkullimit të gjakut te njeriu	Të përshkruajë sistemin e qarkullimit të gjakut te njeriu.
2	2.Gjaku dhe funksionet e tij	Të përshkruajë funksionet e gjakut.

3	3. Zemra e shëndoshë dhe zemra e sëmurë	Të dallojë ndryshimin ndërmjet zemrës së shëndoshë dhe zemrës së sëmurë.
4	4. Rëndësia e dhurimit vullnetar të gjakut	Të njohë rëndësinë e dhurimit vullnetar të gjakut.
<b>Nënlinja III C. Frymëkëmbimi</b>	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
	1. Frymëkëmbimi te njeriu	Të shpjegojë kalimin e ajrit në sistemin e frymëmarrjes.
	2. Kimia e frymëkëmbimit	Të kuptojë kiminë e frymëkëmbimit.
	3. Ajri i pastër dhe rëndësia e tij për shëndetin	Të kuptojë rëndësinë e edukimit shëndetsor dhe rëndësinë e ajrit të pastër
	4. Pyetje dhe ushtrime përmbledhëse	Të kuptojë rëndësinë që ka për shëndetin mos pirja e duhanit, ajri i pastër etj.
<b>Nënlinja IV D. Të ushqyerit dhe ushqimet</b>	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
	1. Përse ushqehemi? Si ndikon të ushqyerit në gjendjen shëndetsore	Të kuptojë se përse ushqehemi. Të njohë ndikimin e të ushqyerit në gjendjen shëndetsore të organizmit.
	2. Pse duhet të përdorim sa më shumë lloje ushqimesh? Piramida ushqimore	Të dijë se përse duhen përdorur ushqime të shumëllojshme. Të njohë piramidën ushqimore
	3. Pse duhet përdorur pak kripë, sheqer dhe yndyrna?	Të njohë se përse duhet të përdoren pak: kripa, sheqeri dhe yndyra
	4. Ndërtimi i aparatit tretës te njeriu	Të njohë ndërtimin e aparatit tretës së njeriut
	5. Çfarë pësojnë ushqimet në gojë, stomak dhe zorrë?	Të njohë ndryshimet që pësojnë ushqimet në gojë, stomak, zorrë.
	6. Kujdesi për dhëmbët	Të njohë rëndësinë e kujdesit për dhëmbët.
	7. Pyetje dhe ushtrime përmbledhëse	Të njohë rolin e të ushqyerit në mirëritjen dhe zhvillimin e organizmit.
<b>Nënlinja V E. Jashtëqitja dhe ekuilibri i organizmit</b>	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>

	1. Aparati i ekskretimit, roli i veshkave	Të analizojë ndërtimin e aparatit të ekskretimit (jashtëqitjes)
	2. Ndërtimi i veshkave	Të shpjegojë formimin dhe kanalizimin e urinës
	3. Veshkat dhe shëndeti	Të diskutojë për masat që duhet të merren për parandalimin e sëmundjeve më të shpeshta në veshkat dhe rrugët urinare.
<b>Nënlinja VI F. Riprodhimi te njeriu</b>	1. Zhvillimet e trupit në pubertet	Të njohë zhvillimin e trupit në pubertet. Të dijë dhe përcaktojë se kur dhe ku prodhohen gametet femërore.
	2. Prodhimi i qelizave seksuale te mashkulli	Të dijë dhe përcaktojë se kur dhe ku prodhohen gametet mashkullorë.
	3. Prodhimi i qelizave seksuale te femra	Të shpjegojë se çfarë është pjekuria seksuale.
	4. Ushtrime	Të arsyetojë dhe ushtrohet për problemet e nënlinjës.
	5. Pllenimi dhe shtatëzania	Të diskutojë mbi pllenimin dhe shtatëzania.
	6. Lindja e fëmijës	Të diskutojë për lindjen dhe zhvillimin e embrionit.
	7. Kontraceptivët dhe aborti	Të diskutojë për abortin dhe metodat e kontraceptimit.
	8. Sëmundjet seksualisht të transmetueshme ( SST)	Të diskutojë se si parandalohen sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
	9. Si transmetohet dhe si nuk transmetohet SIDA?	Të diskutojë si parandalohet HIV/SIDA
	10. Ushtrime, probleme dhe vetëvlerësim	Të arsyetojë dhe ushtrohet për problemet e nënlinjës.
<b>Nënlinja VII G. Sistemi nervor e hormonal dhe komandimi i lëvizjeve</b>	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi Nxënësi/ja duhet:</b>
	1. Sistemi nervor dhe lëvizjet	Të njohë pjesët kryesore të sistemit nervor
	2. Anatomia e sistemit nervor	Te analizojë anatominë e sistemit nervor, ndërtimin e qelizës nervore.
	3. Mesazhet nervore	Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e trurit.
	4. Mesazhet	Të shpjegojë mesazhet nervore dhe

	dhe përpunimi i tyre	përpunimin e tyre
	5. Ndikimi i disa faktorëve mbi qendrat nervore	Të njohë ndikimin e faktorëve të ndryshëm mbi qendrat nervore.
	6. Sistemi nervor sëmurët	Të analizojë raste të sëmurjes së sistemit nervor.
	7. Hormonet, prodhime të gjendrave me sekrecion të brendshëm	Të analizojë hormonet që prodhohen nga gjendrat endocrine.
	8. Hipotalamusi, hipofiza dhe gjendrat e tjera me sekrecion të brendshëm	Të përshkruajë funksionin e hipotalamusit, hipofizës dhe gjendrave me sekrecion të brendshëm.
	9. Ushtrime	Të ushtrohet për të analizuar problem të ndryshme që kanë të bëjnë me sistemin nervor.
	10. Ushtrime	Të arsyetojë dhe ushtrohet për problemet e nënlinjës.
<b>Linja III</b> <b>Shëndeti dhe sëmundjet.</b> <b>Higjiena dhe shëndeti</b>	<b>Titulli i mësimit</b>	<b>Objektiva për çdo orë mësimi</b> <b>Nxënësi/ja duhet:</b>
	1. Koncepti i shëndetit. Shëndeti dhe sjellja	Të arsyetojë mbi konceptin e shëndetit
	2. Çfarë bën mjekësia?	Të dijë se ç'është sëmundja. Të njohë qelizat bakterore dhe viruset.
	3. Mbrojtja e organizmit. Imuniteti. Vaksinat	Të dijë si të mbrohet nga sëmundjet. Të njohë imunitetin dhe vaksinat.
	4. Sëmundjet që shkakton ndotja	Të njohë sëmundjet që shkaktohen nga ndotja.
	5. Drogat dhe toksikomania	Të përshkruajë drogat dhe toksikomaninë.
	6. Efektet negative nga pirja e duhanit	Të njohë efektet negative të duhanit
	7. Pse alkooli është drogë?	Të njohë efektin negativ të alkoolit në organizmin e njeriut.
<b>Përsëritje për të tri linjat: 11 orë</b>	<b>Sipas karakteristikave të klasave, nxënësve, projektohet përsëritja</b>	